



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPLJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRIMILJEN DANA:		27.04.2026	
NR. NËSHTA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG
01-052/01-19351			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPLJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

Zyra e Kryetarit të Komunës

PROCEVERBAL
NGA KONSULTIMI PUBLIK –
PROJEKT RREGULLORJA PËR
TAKSAT DHE GJOBAT
KOMUNALE

HYRJE

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr.15-016/01-63314, e datës 26.12.2024 dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikbërjes dhe vendimarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Komisioni punues ka shpallur në Diskutim Publik – Projekt- Rregulloren për Taksat dhe Gjobat Komunale dhe Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standarteve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

Projekt Rregullore për taksat dhe gjobat komunale

Njoftimi për diskutim publik është shpall në afatin e paraparë ligjor, duke u bazuar në dispozitat e Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, ashtu palët e interesuara janë njoftuar me datën, vendin, kohën për mbajtjen e takimit publik.

Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i konsultimeve publike dhe linku i platformes për konsultime publike të Qeverisë së Kosovës, ku ka qenë në diskutim publik Draft Plani si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet.

Shih linqet:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=43001>

<https://lipjan.rks-gov.net/dokumentet-ne-konsultim-publik/>

Procesverbal nga konsultimi publik i Projekt Rregullores për taksat dhe gjobat komunale

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Ndërsa takimi konsultativ është realizuar në kohën e paraparë siç është cekur më lartë.

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë 14 pjesëmarrës, prej tyre 8 femra dhe 6 meshkuj.

Debatin me qytetarë për të konsultuar Projekt Rregulloren për Taksat dhe Gjobat Komunale e ka hapur dhe zhvilluar nën drejtimin e Fauz Xhemajli, Kryesues i grupit punues nga Drejtorati për Administratë i cili ka njoftuar të pranishmit për qëllimin e debatit si dhe dispozitat e përgjithshme të Projekt-Rregullores.

Fauz Xhemajli fillimisht para të pranishmëve ka prezentuar dokumentin përkatësisht Projekt – Rregulloren për Taksat dhe Gjobat Komunale qëllimi i së cilës është që është që Komuna të krijoj burime të të hyrave vetanake buxhetore në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal si dhe përcaktimi i gjobave apo sanksioneve kundërvajtëse për rastet e shkeljeve të dispozitave të kësaj Rregulloreje. Ai posaqërisht ka sqaruar disa ndryshime që kanë ndodhur te taksat e gjendjes civile si legalizimi i kurorave 10 €, Regjistrimi i fëmijëve të lindur jashtë martesës (regjistrimi i veqantë) 5 €, te neni 9, pjesa tabelare numri rendor 2 ,Shfrytëzimi i sipërfaqeve para objekteve të biznesit për veprimtarinë e cila është e lejuar të ushtrohet edhe jashtë objektit dhe për ekspozimin e mallrave të lejuara nga 1€ është ndryshuar në 2 € në bazë mujore për m2.



Procesverbal nga konsultimi publik i Projekt Rregullore për taksat dhe gjobat komunale

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Gjatë këtij takimi të pranishmit paten rastin të bëjnë pyetje dhe të paraqesin komente rreth këtij dokumenti.

Valdete Muji ka parashtuar pyetjen se me këtë Propozim Rregullorë a janë paraparë taksat edhe për shfrytëzuesit e pronës komunale për 99 vite.

Kësaj pyetje i është përgjigjur anëtaria e Komisionit Vlora Krasniqi e cila ka njoftuar se në nenin 23 të kësaj Propozim-Rregulloreje janë paraparë Taksat për pronat komunale që ipen në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë me vendime të Kuvendit të Komunës, konform dispozitave të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme dhe akteve nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

Ky koment i Valdete Mujit është pranuar nga Komisionin terësisht

Saranda Krasniqi ka kërkuar që Taksat për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale të dallohen sipas zonave .

Vlora Krasniqi edhe këtu e sqaroi komentuesen se te dhënia në shfrytëzim afatshkurtër taksat apo qiraja për lokale dhe objekte afariste është dalluar sipas zonave mirëpo te dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronave të paluajtshme për shkak të numrit të madh të pronave të paluajtshme nëpër fshatra ka qenë e pamundshme të bëhet ndarja nëpër zona.

Komenti i Saranda Krasniqit është pranuar plotësisht nga Komisioni

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuesve
Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	15 ditë pranohen	14
Publikimi në ueb faqe	15 ditë	

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë **14** pjesëmarrës, prej tyre **8** femra dhe **6** meshkuj.